



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DURRËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 55, datë 31.05.2022

**PËR**

**MIRATIMIN NË PARIM TË VLERËS FINANCIARE TË SHPRONËSIMIT PREJ 21561573.6 (NJËZETË E NJË MILION E PESËQIND E GJASHTËDHJETË E NJË MIJË E PESËQIND E SHTATËDHJETË E TRE PIKË GJASHTË) LEKË, PËR PASURITË, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA INVESTIMI PUBLIK ME OBJEKT: “RIKONSTRUKSION RRUGA APULIA” (PARALEL ME LINJËN HEKURUDHORE – PLAZH)**

Në mbështetje të nenit 41 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9, pika 1.2/b të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar, VKM-së nr. 395, datë 13.05.2021 “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin”, sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria Ligjore, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D O S I :**

1. Miratimin në parim të vlerës financiare të shpronësimit prej 21561573.6 (njëzetë e një milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e tre pikë gjashtë) lekë, për pasuritë, pronë private, që preken nga investimi publik me objekt: “Rikonstruksion rruga Apulia” (paralel me linjën hekurudhore – plazh), sipas tabelës së hartuar nga grupi i punës, i ngarkuar për kryerjen e vlerësimit paraprak.

2. Fondi i shpronësimit me vlerë 21561573.6 (njëzetë e një milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e tre pikë gjashtë) lekë, të parashikohet në buxhetin e vitit 2023-2025. Lëvrimi i fondit do të kryhet pasi të jetë botuar VKM-ja për shpronësim.
3. Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria Ligjore të ndjekë procedurën e shpronësimit me Agjencinë Shtetërore për Shpronësim.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

### KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



**U shpall sot me datë 01.06.2022**

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "RIKONSTRUKSION RRUGA APULIA" (PARALEL ME LINJËN HEKURUDHORE – PLAZH)

| Nr | Pronari  |        |         | Të dhënat<br>Mbi pasurinë sipas ASHK-së |          |            |                               | Vlerësimi për<br>Shpronësim sipas llojit të pasurisë |                           |                     | Shënime   |
|----|--|--------|---------|---|----------|------------|-------------------------------|--|---------------------------|---------------------|---|
|    | Emri   | Atësia | Mbiemri | ZK                                      | Nr. pas. | Lloji pas. | Sip. Totale (m <sup>2</sup> ) | Shpronësim tokë "truall"                             |                           |                     |   |
|    |  |        |         |   |          |            |                               | Sip. që shpronësohet (m <sup>2</sup> )               | Çmimi Lekë/m <sup>2</sup> | Vlera Totale (lekë) |   |
| 1  | <u>Bashkëpronarët:</u><br>Lejla Teufik Hazedari<br>Violeta Teufik Manushi<br>Hasan Teufik Kalatsi<br>Klebeta Sabri Kalatsi<br>Denada Sabri Negollari   |        |         | 8518                                    | 48/14    | Truall     | 1967                          | 404  | 19336                     | 7811744             | Konfirmuar nga ASHK DV Durrës   |
| 2  | <u>Bashkëpronarët:</u><br>Arianita Gezim Hasa<br>Bujare Hasa<br>Fatmir Hasa<br>Kujtim Hasa<br>Mynyre Hasa<br>Neta Hasa<br>Teuta Starova<br>Tomorr Hasa   |        |         | 8518                                    | 48/20    | Truall     | 3870                          | 214  | 19336                     | 4137904             | Konfirmuar nga ASHK DV Durrës   |
| 3  | Nezir Vjosa  |        |         | 8518                                    | 48/37    | Truall     | 500                           | 19   | 19336                     | 367384              | Konfirmuar nga ASHK DV Durrës   |
| 4  | Andrea Nazniku   |        |         | 8518                                    | 48/51    | Truall     | 300                           | 6.1  | 19336                     | 117949.6            | Kufizohen veprimet për këtë pasuri deri në plotësimin e dokumentacionit teknio-ligjor |
| 5  | <u>Bashkëpronarët:</u><br>Dhurata Magjistari<br>Elin Magjistari<br>Fellenza Koçi<br>Kimete Gjoka<br>Lumturi Xhabija<br>Maksim Haxhiu<br>Martin Magjistari<br>Merushe Haxhiu<br>Miguel Magjistari |        |         | 8518                                    | 48/19    | Truall     | 1065                          | 415  | 19336                     | 8024440             | Konfirmuar nga ASHK DV Durrës   |

|                               |   |      |       |        |      |      |              |                   |                                     |
|-------------------------------|---|------|-------|--------|------|------|--------------|-------------------|-------------------------------------|
|                               | Silvana Leka<br>Xheni Agovi   |      |       |        |      |      |              |                   |                                     |
| 6                             | Bashkëpronarët:<br>Kime Gjoça<br>Dhurata Magjistari<br>Martin Magjistari<br>Miguel Arbër Magjistari<br>Elin Magjistari<br>Silvana Leka<br>David Leka<br>Maksim Haxhiu<br>Merushe Haxhiu<br>Thellenza Koçi<br>Lumturi Xhabija<br>Xheni Agovi | 8518 | 48/13 | Truall | 1200 | 57   | 19336        | 1102152           | Konfirmuar nga<br>ASHK DV<br>Durrës |
| <b>Vlera totale paraprake</b> |   |      |       |        |      | ---- | <b>19336</b> | <b>21561573.6</b> |                                     |

*Shënim: Për tokën "truall", çmimi i llogaritur është marrë nga Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 89, datë 3.2.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës se tokës në Republikën e Shqipërisë"*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 474 / 12 prot.

Durrës, më 07.06.2022

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK ✓  
DURRËS

KRYETARIT TË BASHKISË  
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.55 datë 31.05.2022 “Për miratimin në parim të vlerës financiare të shpronësimit prej 21561573.6 (njëzetë e një milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e tre pikë gjashtë ) lekë, për pasuritë, pronë private, që preken nga investimi publik me objekt: “rikonstruksion rruga Apulia” (paralel me linjën hekurudhore – plazh)”

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI  
EMILJAN JANI

